

URDHËR
Nr. 1347, datë 14.8.2024

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të pikës 3, të nenit 15, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” dhe të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të sekretarit të përgjithshëm z. Gjergji Methoxha, drejtor i përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Mbrojtjes, në Ministrinë e Mbrojtjes.

2. Kompetencat e deleguara të sekretarit të përgjithshëm do të ushtrohen deri në emërimin e sekretarit të përgjithshëm.

3. Ngarkohet z. Gjergji Methoxha për zbatimin e këtij urdhri, Sektori i Arkiv-Protokollit për njoftimin e këtij urdhri, si dhe të gjithë punonjësit për zbatim.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I MBROJTJES
Pirro Vengu